

Nr . _____ Prot.

Tiranë, me _____.____.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim për kontrollin periodik dhe mirëmbajtjen e sistemit të mbrojtjes nga zjarri për 12 muaj”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 24951230-6 “Mbushje për bombola gazi zjarrfikës”; 24951210-0 “Pluhur për bombola gazi zjarrfikës”; 31625200-5 “Sistem alarmi antizjarr”; 35111300-8 “Fikëse zjarri”.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,489,011 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëmbëdhjetë) lek pa TVSH.

Përllogaritja e fondit limit është referuar në nenin 76/1 (b) të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “...Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim...”. Përllogaritja e fondit limit është kryer nga struktura e posacme e ngritur me urdhër të vecantë dhe bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të

Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilat parashikohet se:

Neni 82, i LPP-së, pika 1: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP-së: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se e 40 % të vlerës së përllogaritur të Marrëveshjes Kuadër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” dhe pikën 1 të nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”... “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31

mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlllogaritur të Marrëveshjes Kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur

duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë Licensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit Kodi I.2.A .

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në përputhje me Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, “Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme)

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të kryer shërbime dhe që janë vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri,

pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që shërbimi të kryhet me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij të paktën:

- 1 (një) ekspert zjarrfikës të pajisur me Certifikatë.

Për ekspertin zjarrfikës të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mekanik/Elektrik/Sigurisë/Mjedisit ose fusha të ngjashme që lidhen me objektin e kontratës.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune.
- Kontrate pune perkatese e vlefshme.
- Librezë pune.

b) Minimalisht 3 (tre) punonjes për realizimin e procesit të shërbimit, për të cilët duhet të paraqiten:

- Certifikata kualifikimi nga institucionet e licencuara për kryerjen e trajnimeve në fushën sistemit të mbrojtjes nga zjarri, sipas legjislacionit në fuqi;
- Kontrata e punës e vlefshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, si dhe referuar pikes 3 të rekomandimit të APP-së nr. 5168 prot., datë 18.07.2024 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit publik për mallra, punë, shërbime”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës së shërbimeve, që kërkohen të prokurohen si dhe bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik dhe legjislacionit të posaçëm në përputhje me objektin e prokurimit, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Numri i punonjësve është kërkuar, në bazë të një përlllogaritjeje mesatare në raport me numrin dhe sipërfaqet e ambienteve, në administrim të AK, ku do të jetë e nevojshme kryerja e shërbimeve, si dhe në funksion të faktit që duhet të kryhen në momente specifike, dhe kjo garanton zhvillimin e shërbimit me disponibilitet të plotë në kohë, sasi dhe cilësi. Kjo strukturë organizative siguron

mbulimin e plotë të të gjitha fazave të shërbimit, duke garantuar realizimin e suksesshëm të shërbimit në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat teknike të përcaktuara.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto kërkesa nuk krijojnë kufizime të pajustificuara të konkurrencës, pasi janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe janë të domosdoshme për verifikimin e kapacitetit teknik e profesional të operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në procedurë.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë 1 (një) auto laborator profesional të tipit kombinat i cili të mundëson kryerjen e të gjithë shërbimit të kërkuar në vend sipas procesit të mëposhtëm në prani të specialistëve të ngarkuar nga A.K:

a) Provën e presionit hidraulik të fikseve të zjarrit si dhe provën e presionit të tubave zjarrfikës për përdorim në hidrante dhe automjete zjarr fikse.

b) Rimbushjen dhe kolaudimin sipas llojit të lëndëve shuarëse: pluhur, shkumë, CO2.

Për laboratorin, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë skeden teknike si dhe katalogun përkatës ku specifikohen qartësisht proceset e punës për të cilat është prodhuar.

- Kur mjeti është në pronësi, duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

- Kur mjeti nuk është në pronësi të ofertuesit duhet të paraqitet: kontrata e qirasë/huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit.

Shënim: *Për plotësimin e kriterëve 2.3.4 dhe 2.3.5 operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DT, ndërsa përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari bën dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të jenë origjinale ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

Kërkesa për disponimin e një (1) auto-laboratori profesional të tipit kombinat është vendosur në funksion të realizimit të objektit të kontratës, pasi shërbimet e testimit hidraulik, rimbushjes dhe kolaudimit të fikseve të zjarrit duhet të kryhen në vend, pranë ambienteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke garantuar vijimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe shmangien e ndërprerjeve të panevojshme të shërbimit.

Kjo kërkesë i shërben verifikimit të kapacitetit teknik të operatorit ekonomik për të realizuar shërbimin me pajisje të përshtatshme dhe të specializuara, në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e skedës teknike, katalogut të mjetit, si dhe dokumentacionit që provon disponueshmërinë ligjore të tij (pronësinë ose kontratën e qirasë/huapërdorjes, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe policën e sigurimit), është e nevojshme për të vërtetuar se operatori ekonomik disponon mjetin e kërkuar dhe se ai është i përshtatshëm dhe i autorizuar për përdorim gjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor konform specifikimeve teknike.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se shërbimi do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjet përkatëse të caktuara nga Autoriteti Kontraktor.*

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të elementeve të shërbimit objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Mirëmbajtja periodike e pajisjeve kundër zjarrit

Mirëmbajtja periodike e pajisjeve kundër zjarrit ka për qëllim garantimin e funksionimit të sigurt, efektiv dhe në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat ligjore në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Operatori ekonomik duhet të realizojë kontrollin teknik periodik të të gjitha pajisjeve kundër zjarrit të instaluara në ambientet e 11 Centraleve të Sterilizimit dhe të Qendrës së Logjistikës si dhe kur nevojitet zëvendësimin e tyre, duke siguruar që çdo pajisje të jetë në gjendje optimale pune dhe e gatshme për përdorim në çdo moment emergjence.

Shërbimi i mirëmbajtjes duhet të kryhet nga personel teknik i kualifikuar dhe i certifikuar, në përputhje me standardet teknike përkatëse dhe rekomandimet e prodhuesve të pajisjeve. Gjatë procesit të mirëmbajtjes, operatori ekonomik duhet të kryejë kontroll të detajuar vizual dhe teknik për secilën pajisje kundër zjarrit, duke verifikuar integritetin fizik, gjendjen funksionale dhe sigurinë operacionale të tyre.

Kontrolli vizual duhet të përfshijë inspektimin e jashtëm të pajisjeve për evidentimin e dëmtimeve fizike, deformimeve, korrozionit, ndryshkut, çarjeve, konsumimit të materialeve ose çdo anomalie tjetër që mund të ndikojë në funksionimin normal të pajisjes. Gjithashtu duhet të kontrollohet vendosja e pajisjeve në pozicionet e përcaktuara, aksesueshmëria e tyre dhe sinjalistika identifikuese.

Kontrolli i presionit duhet të realizohet përmes verifikimit të manometrave ose pajisjeve matëse të presionit, me qëllim evidentimin e nivelit të presionit brenda parametrave teknikë të lejuar. Në rastet kur konstatohet ulje ose tejkalim i presionit të lejuar, operatori ekonomik duhet të marrë masat e nevojshme për rikthimin e pajisjes në parametrat funksionalë, përfshirë rimbushjen ose zëvendësimin e komponentëve përkatës.

Kontrolli i valvulave dhe mekanizmave të aktivizimit duhet të përfshijë verifikimin e funksionimit korrekt të tyre, kontrollin e elementëve bllokues, levave të përdorimit, kunjave të sigurisë dhe pjesëve lidhëse, me qëllim garantimin e aktivizimit të menjëhershëm dhe të sigurt të pajisjes në rast emergjence.

Kontrolli i tubacioneve, zorrëve fleksibël dhe aksesorëve ndihmës duhet të realizohet për të evidentuar dëmtime, plasaritje, bllokime, konsumime apo rrjedhje të mundshme. Çdo element i dëmtuar ose jashtë parametrave teknikë duhet të zëvendësohet menjëherë nga operatori ekonomik.

Kontrolli i vulave të sigurisë dhe elementëve identifikues duhet të kryhet për të verifikuar paprekshmërinë e pajisjeve dhe vlefshmërinë e kontrolleve të mëparshme teknike. Pajisjet që rezultojnë pa vulë sigurie ose me vulë të dëmtuar duhet t'i nënshtrohen verifikimeve të plota teknike dhe, sipas rastit, procedurave të rimbushjes ose kolaudit.

Pastrimi teknik i pajisjeve duhet të kryhet në mënyrë periodike për të siguruar ruajtjen e kushteve optimale të funksionimit. Pastrimi duhet të përfshijë heqjen e pluhurave, papastërtive, yndyrnave ose elementëve të tjerë që mund të ndikojnë negativisht në përdorimin dhe jetëgjatësinë e pajisjeve kundër zjarrit.

Kolaudimi dhe testimi teknik i pajisjeve kundër zjarrit

Kolaudimi i pajisjeve kundër zjarrit është një proces teknik i detyrueshëm, i cili kryhet me qëllim verifikimin e gjendjes funksionale, sigurisë teknike dhe përputhshmërisë së pajisjeve me standardet dhe kërkesat ligjore në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Procesi i kolaudimit duhet të kryhet nga personel teknik i specializuar dhe i autorizuar për ushtrimin e këtij aktiviteti, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, standardet teknike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe rekomandimet teknike të prodhuesve të pajisjeve kundër zjarrit.

Kolaudimi duhet të përfshijë kontrollin e plotë teknik dhe funksional të pajisjeve kundër zjarrit, përfshirë fikëset portative, sistemet hidrante, sistemet e sinjalizimit të zjarrit, pajisjet e emergjencës dhe çdo komponent tjetër të lidhur me sigurinë kundër zjarrit.

Testi funksional duhet të realizohet për të verifikuar gatishmërinë operative dhe funksionimin korrekt të pajisjeve kundër zjarrit. Gjatë këtij procesi duhet të kontrollohen të gjithë elementët funksionalë të pajisjes, përfshirë: mekanizmat e aktivizimit; valvulat dhe sistemet e shkarkimit; manometrat dhe treguesit e presionit; tubat fleksibël dhe aksesoret ndihmës; sistemet e komandimit dhe sinjalizimit; integriteti i trupit të pajisjes.

Testi funksional duhet të evidentojë çdo defekt, bllokim, rrjedhje, humbje presioni ose problematikë tjetër që mund të ndikojë në performancën dhe sigurinë e pajisjes gjatë përdorimit në situata emergjente.

Për sistemet e alarmit dhe sinjalizimit të zjarrit, operatori ekonomik duhet të kryejë testimin e sensorëve, detektorëve të tymit, sirenave, paneleve të komandimit, baterive rezervë dhe elementëve të ndriçimit emergjent, me qëllim garantimin e funksionimit të tyre korrekt dhe aktivizimit automatik në rast zjarri.

Testi hidrostatik duhet të realizohet në përputhje me afatet dhe procedurat teknike të përcaktuara nga legjislacioni dhe standardet përkatëse për pajisjet nën presion. Ky test ka për qëllim verifikimin e rezistencës mekanike dhe integritetit strukturor të trupit të pajisjeve kundër zjarrit, veçanërisht të bombolave të fikëseve. Gjatë testit hidrostatik, pajisja duhet të vendoset nën presion të kontrolluar, sipas parametrave teknikë të përcaktuar nga prodhuesi dhe standardet përkatëse, për të evidentuar: deformime të mundshme; çarje ose mikroçarje; rrjedhje; dobësim të materialit; korrozion të brendshëm ose të jashtëm; humbje të qëndrueshmërisë strukturore.

Çdo pajisje që nuk rezulton i rregullt gjatë testit hidrostatik duhet të nxirret jashtë përdorimit dhe të zëvendësohet ose riparohet sipas rastit, në përputhje me rekomandimet teknike dhe kërkesat ligjore.

Pas përfundimit të kolaudimit dhe verifikimit teknik, operatori ekonomik duhet të pajisë me certifikatë të vlefshme çdo pajisje që rezulton funksionale dhe në përputhje me parametrat teknikë dhe standardet e sigurisë.

Certifikata e kolaudimit duhet të përmbajë minimalisht: të dhënat identifikuese të pajisjes; llojin dhe kapacitetin e pajisjes; vendndodhjen e saj; datën e kolaudimit; afatin e vlefshmërisë së kolaudimit; rezultatet e testimeve; emrin dhe nënshkrimin e teknikëve përgjegjës; vulën dhe të dhënat e operatorit ekonomik.

Operatori ekonomik duhet të vendosë gjithashtu etiketa identifikuese dhe kontrolli teknik mbi pajisjet e kolauduara, ku të evidentohen data e kontrollit dhe data e kolaudimit të ardhshëm.

Rimbushja e pajisjeve kundër zjarrit

Shërbimi i rimbushjes së pajisjeve kundër zjarrit duhet të realizohet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, standardet teknike kombëtare dhe ndërkombëtare për pajisjet nën presion, si dhe specifikimet teknike të prodhuesve të pajisjeve kundër zjarrit. Qëllimi i këtij shërbimi është rikthimi i pajisjeve në gjendje optimale funksionale, duke garantuar gatishmërinë dhe efikasitetin e tyre në rast emergjence.

Operatori ekonomik duhet të realizojë rimbushjen e të gjitha pajisjeve kundër zjarrit që rezultojnë: të përdorura; me humbje presioni; me skadim të afatit të vlefshmërisë së lëndës fikëse; pas përdorimit qoftë edhe pjesor; jashtë parametrave teknikë të funksionimit; me mungesë të vulës së sigurisë ose sipas kërkesave të kontrollit teknik periodik.

Procesi i rimbushjes duhet të kryhet vetëm nga personel teknik i kualifikuar dhe i autorizuar, në ambiente dhe me pajisje të përshtatshme teknike për këtë lloj shërbimi. Të gjitha materialet fikëse që do të përdoren gjatë rimbushjes duhet të jenë të certikuara, brenda afatit të përdorimit dhe të shoqëruara me dokumentacionin teknik përkatës. Çdo pajisje që paraqet dëmtime strukturore, korrozion të avancuar ose probleme që cenojnë sigurinë në përdorim, duhet të nxirret jashtë funksionit dhe të rekomandohet për zëvendësim.

Rimbushja e fikëseve me pluhur duhet të kryhet me pluhur fikës të certifikuar, të përshtatshëm për klasat e zjarrit për të cilat pajisja është projektuar. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që materiali fikës të jetë i ri, i pastër dhe brenda parametrave teknikë të përcaktuar nga standardet përkatëse.

Procesi i rimbushjes duhet të përfshijë: shkarkimin dhe zbrazjen e plotë të pluhurit ekzistues/shkumë; pastrimin e brendshëm të bombolës nga mbetjet dhe lagështira; kontrollin e gjendjes së tubit të brendshëm të shkarkimit; kontrollin dhe pastrimin e valvulës; mbushjen me sasinë e përcaktuar të pluhurit fikës; vendosjen e gazit shtytës sipas parametrave teknik; kontrollin e presionit operacional dhe testimin e hermeticitetit dhe funksionalitetit të pajisjes.

Pas përfundimit të procesit, pajisja duhet të vuloset dhe të pajiset me etiketë identifikuese ku të pasqyrohen: data e rimbushjes; data e kontrollit të ardhshëm; emri i operatorit ekonomik; emri i teknikut përgjegjës.

Rimbushja e fikëseve me dioksid karboni (CO₂) duhet të kryhet në kushte teknike të sigurta dhe me pajisje të specializuara për punë me gaze nën presion. Operatori ekonomik duhet të përdorë CO₂ teknik të certifikuar dhe të përshtatshëm për përdorim në pajisje kundër zjarrit. Procesi i rimbushjes duhet të përfshijë: kontrollin e peshës së bombolës; kontrollin e trashësisë dhe integritetit të trupit të bombolës; verifikimin e valvulës së shkarkimit; kontrollin e tubit dhe grykës së shpërndarjes; mbushjen me sasinë e përcaktuar të gazit CO₂; testimin për rrjedhje; kontrollin e presionit sipas parametrave teknikë.

Për shkak të presionit të lartë të funksionimit, operatori ekonomik duhet të garantojë që bombolat e CO₂ të kalojnë testin hidrostatik sipas afateve ligjore dhe standardeve teknike përkatëse. Pas rimbushjes, pajisjet duhet të vulosen dhe të certifikohen për përdorim, duke vendosur etiketat e kontrollit teknik dhe identifikimit.

Rimbushja e fikëseve me shkumë duhet të realizohet me solucion shkumëzues të certifikuar dhe të përshtatshëm për klasat specifike të zjarrit. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që solucionet e përdorura të jenë brenda afatit të përdorimit dhe të ruajnë vetitë fikëse sipas standardeve teknike. Procesi i rimbushjes duhet të përfshijë: zbrazen e plotë të solucionit ekzistues; pastrimin e rezervuarit dhe komponentëve të brendshëm; kontrollin e valvulave dhe tubave të shpërndarjes; mbushjen me solucionin shkumues sipas kapacitetit të pajisjes; vendosjen e presionit operacional; testimin funksional të sistemit të shpërndarjes së shkumës; kontrollin për rrjedhje ose humbje presioni.

Operatori ekonomik duhet të garantojë që solucionet shkumëzuese të përdorura të mos jenë të degraduara ose të papërshtatshme për përdorim.

Pas përfundimit të rimbushjes, operatori ekonomik duhet të realizojë kontrollin final teknik dhe funksional të çdo pajisjeje, duke verifikuar: presionin e punës; funksionimin korrekt të mekanizmave të aktivizimit; mungesën e rrjedhjeve; integritetin e vulave të sigurisë; gatishmërinë e pajisjes për përdorim emergjent.

Çdo pajisje e rimbushur duhet të pajiset me: vulë sigurie; etiketë kontrolli teknik; etiketë identifikuese të rimbushjes; datën e rimbushjes; afatin e kontrollit të ardhshëm.

Në përfundim të shërbimit, operatori ekonomik duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor: raportin teknik të rimbushjes; listën e pajisjeve të trajtuara; certifikatat përkatëse të kontrollit; evidencën e materialeve të përdorura.

Instruktimi dhe trajnimi i stafit për mbrojtjen kundër zjarrit

Operatori ekonomik duhet të organizojë dhe zhvillojë instruktimin dhe trajnimin teorik dhe praktik të stafit të Autoritetit Kontraktor, me qëllim rritjen e njohurive dhe kapaciteteve për parandalimin, identifikimin dhe menaxhimin e situatave emergjente që lidhen me rrezikun nga zjarri. Trajnimi duhet të realizohet për personelin e 11 centraleve të sterilizimit dhe të Qendrës së

Logjistikës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe me procedurat e sigurisë në punë.

Qëllimi i instruktimit është garantimi që personeli të jetë i aftë: të identifikojë rreziqet potenciale të zjarrit në ambientet e punës; të përdorë në mënyrë korrekte pajisjet kundër zjarrit; të reagojë në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt në rast emergjence; të zbatojë procedurat e evakuimit; të kontribuojë në minimizimin e dëmeve ndaj personave, pajisjeve dhe ambienteve. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin programin e trajnimit, metodologjinë e zhvillimit dhe materialet didaktike që do të përdoren gjatë instruktimit.

Instruktimi duhet të përfshijë njohjen praktike dhe teorike të pajisjeve kundër zjarrit të instaluara në ambientet e Autoritetit Kontraktor, demonstrim praktik për mënyrën e përdorimit të fikëseve. Personeli duhet të informohet mbi mënyrën e mbajtjes, aktivizimit dhe drejtimit të fluksit të materialit fikës, si dhe mbi distancën e sigurt të përdorimit gjatë ndërhyrjes ndaj zjarrit.

Personeli duhet të trajnohet për: identifikimin e burimeve të mundshme të zjarrit; zgjedhjen e pajisjes së përshtatshme për fikjen e secilit lloj zjarri; rreziqet që lidhen me përdorimin e gabuar të pajisjeve kundër zjarrit; masat parandaluese për shmangien e incidenteve. Instruktimi duhet të përfshijë procedurat standarde të evakuimit në rast zjarri ose emergjence tjetër. Operatori ekonomik duhet të shpjegojë planin e evakuimit të ambienteve dhe të evidentojë: rrugët e emergjencës; daljet e sigurisë; pozicionimin e pajisjeve kundër zjarrit; vendet e grumbullimit të stafit.

Tabela e Inventarit të Pajisjeve

Fikset e zjarit sipas Centraleve të Sterilizimit					
Centrali	Shërbimi	Lloji pajisjes dhe Kapaciteti	Njësia	Sasia	Data skadencës
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Dibër	Rikarikim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	3	12.11/.2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Dibër	Rikarikim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	2	12.12.2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar të Traumës	Rikarikim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	4	Gusht 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar të Traumës	Rikarikim + Rimbushje	Fikse zjarri 6 kg pluhur	copë	3	Gusht 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Shkodër	Rikarikim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	4	Mars 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal	Rikarikim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	5	Mars 2026

Shkodër					
Stacioni i Sterilizimit pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	5	Maj 2026
Stacioni i Sterilizimit pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	5	Maj 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Durrës	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	3	1.1.2027
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Durrës	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	3	1.1.2027
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”, Tiranë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	3	Maj 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni”, Tiranë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	5	Maj 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak “Ihsan Cabej” Lushnjë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	5	25/09/2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak “Ihsan Cabej” Lushnjë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	5	25.09.2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	2	korik 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	2	korik 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Vlorë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	5	Prill 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak Mat	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	1	Dhjetor 2026

Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak Mat	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	2	Dhjetor 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak “Isa Zllami” Tropojë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	1	Shtator 2026
Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak “Isa Zllami” Tropojë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	2	Shtator 2026
Qendra e Logjistikës, Tiranë	Rikaritim + Rimbushje	Fikse zjarri 5 kg CO2	copë	7	Dhjetor 2026
Qendra e Logjistikës, Tiranë	Vendosje	Fikse zjari 6 kg pluhur	copë	3	

Preventiv

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi/njësi (lek)	Vlera (lek)
1	Kontroll teknik fikëse me shkumë	copë			
2	Kontroll teknik fikëse CO ₂	copë			
3	Rimbushje fikëse pluhuri	copë			
4	Test hidrostatik	copë			
5	Kontroll sistem alarmi	sistem	12		
6	Trajnim stafi	seancë	12		
7	Raportim dhe certifikim	herë	1		

TERMAT E REFERENCËS (TOR)

Objekti:“Shërbim për kontrollin periodik, mirëmbajtjen, kolaudimin, testimin, rimbushjen e pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, si dhe trajnimin e stafit për menaxhimin e emergjencave”

Operatori ekonomik, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë kapacitetet profesionale, teknike, organizative dhe njerëzore të nevojshme për garantimin e kontrollit periodik, mirëmbajtjes, testimit, kolaudimit, rimbushjes, certifikimit dhe dokumentimit të gjendjes teknike të pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri.

Shërbimet duhet të realizohen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, standardet teknike përkatëse, kërkesat e prodhuesve të pajisjeve dhe praktikatat e mira të mirëmbajtjes teknike.

Operatori ekonomik duhet të garantojë që pajisjet kundër zjarrit të jenë funksionale, të kontrolluara, të mirëmbajtura dhe të gatshme për përdorim në rast emergjence.

Operatori ekonomik duhet të jetë subjekt i regjistruar dhe të disponojë dokumentacionin ligjor të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit që lidhet me shërbimet e mbrojtjes nga zjarri.

Operatori ekonomik duhet të garantojë realizimin e shërbimeve nga personel i kualifikuar, duke përdorur pajisje dhe instrumente teknike të përshtatshme.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë planin e organizimit të shërbimit, ku të përcaktohen mënyra e realizimit të kontrolleve dhe mirëmbajtjeve, grafiku i vizitave, struktura e personelit, përgjegjësitë, mënyra e raportimit dhe komunikimi me Autoritetin Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet, instrumentet dhe mjetet teknike të nevojshme për realizimin e shërbimeve të kontrollit, mirëmbajtjes, testimit, kolaudimit dhe rimbushjes së pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri.

Të gjitha pajisjet matëse dhe instrumentet e kontrollit duhet të jenë të pajisura me certifikata kalibrimi të vlefshme. Pajisjet dhe mjetet teknike duhet të jenë në gjendje të mirë pune dhe të disponueshme gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Kontrolli Fillestar Teknik

Në fillim të kontratës, operatori ekonomik duhet të realizojë kontrollin teknik fillestar të të gjitha pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, me qëllim evidentimin e gjendjes reale teknike dhe përcaktimin e masave të nevojshme për funksionimin e sigurt të tyre.

Kontrolli fillestar duhet të përfshijë verifikimin fizik, teknik dhe funksional të pajisjeve, duke evidentuar:

1. pajisjet që janë funksionale dhe të gatshme për përdorim;
2. pajisjet që paraqesin defekte ose mangësi teknike;
3. pajisjet jashtë funksionit ose që kërkojnë zëvendësim;
4. ndërhyrjet e nevojshme për riparim, mirëmbajtje ose përmirësim teknik.

Pas përfundimit të kontrollit, operatori ekonomik duhet të përgatisë dhe të dorëzojë një raport teknik fillestar pranë Autoritetit Kontraktor, i cili do të shërbejë si dokument bazë për organizimin e shërbimeve periodike dhe monitorimin e gjendjes së pajisjeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Mirëmbajtja Periodike

Operatori ekonomik duhet të realizojë mirëmbajtjen periodike të pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, me qëllim garantimin e funksionimit të sigurt dhe të vazhdueshëm të tyre.

Mirëmbajtja duhet të përfshijë minimalisht:

1. kontrollin vizual të gjendjes fizike të pajisjeve;
2. kontrollin e presionit, valvulave dhe elementëve funksionalë;
3. verifikimin e tubacioneve, vulave dhe komponentëve përbërës;
4. kontrollin e etiketave dhe afateve të kontrollit teknik;
5. realizimin e testeve funksionale për verifikimin e gatishmërisë së pajisjeve.

Çdo problematikë ose defekt i konstatuar duhet të evidentohet në raportin teknik të shërbimit dhe të shoqërohet me masat e nevojshme për riparim, zëvendësim ose ndërhyrje të mëtejshme.

Kolaudimi dhe Testimi Teknik

Operatori ekonomik duhet të realizojë kolaudimin dhe testimin teknik të pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, me qëllim verifikimin e gjendjes funksionale dhe përputhshmërisë së tyre me kërkesat teknike.

Procesi duhet të përfshijë:

1. testimin funksional të pajisjeve kundër zjarrit;
2. kontrollin e mekanizmave, valvulave dhe elementëve funksionalë;
3. kontrollin dhe testimin e sistemeve të alarmit dhe sinjalizimit të zjarrit;
4. realizimin e testeve hidrostatike për pajisjet nën presion, sipas kërkesave përkatëse.

Pajisjet që rezultojnë funksionale duhet të pajisen me certifikatë kontrolli/kolaudimi dhe dokumentacion teknik që përmban datën e kontrollit, rezultatet e testimit, afatin e ardhshëm të kontrollit dhe të dhënat e teknikut përgjegjës.

Rimbushja e Pajisjeve

Operatori ekonomik duhet të realizojë rimbushjen e pajisjeve kundër zjarrit kur ato nuk plotësojnë parametrat teknikë të përdorimit, me qëllim rikthimin e tyre në gjendje funksionale.

Rimbushja duhet të kryhet për pajisjet që:

1. janë përdorur ose kanë pësuar shkarkim;
2. kanë humbje presioni;
3. kanë material fikës jashtë afatit të përdorimit;

4. rezultojnë jashtë parametrave teknike gjatë kontrolleve.

Procesi duhet të realizohet nga personel i kualifikuar, duke përdorur materiale të përshtatshme dhe të certifikuara, si dhe duke verifikuar gjendjen e bombolës, valvulave dhe komponentëve përbërës.

Pas rimbushjes, pajisjet duhet të testohen funksionalisht dhe të pajisen me etiketë teknike dhe dokumentacion përkatës që përmban datën e ndërhyrjes, afatin e kontrollit të ardhshëm dhe të dhënat e teknikut përgjegjës.

Menaxhimi i Pajisjeve Jashtë Funksionit

Operatori ekonomik duhet të evidentojë dhe raportojë çdo pajisje që rezulton jashtë funksionit, e dëmtuar ose që nuk përmbush kërkesat teknike të sigurisë.

Për këto pajisje operatori duhet të:

1. përcaktojë arsyen e mosfunksionimit;
2. vlerësojë mundësinë e riparimit;
3. rekomandojë zëvendësimin kur riparimi nuk është teknikisht i mundur;
4. dokumentojë masat e marra dhe statusin përfundimtar të pajisjes.

Trajnimi i Personelit

Operatori ekonomik duhet të realizojë trajnimin teorik dhe praktik të personelit të Autoritetit Kontraktor për parandalimin dhe menaxhimin e situatave emergjente nga zjarri.

Trajnimi duhet të përfshijë:

1. përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit dhe fikëseve;
2. reagimin në rast zjarri dhe procedurat e evakuimit;
3. përdorimin e sistemeve të alarmit dhe sinjalizimit;
4. identifikimin e rreziqeve dhe masat parandaluese.

Trajnimi duhet të kombinojë pjesën teorike me ushtrime praktike. Pas përfundimit, operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin përkatës, përfshirë programin e trajnimit, listën e pjesëmarrësve dhe raportin e realizimit të trajnimit.

Raportimi dhe Dokumentacioni

Operatori ekonomik duhet të sigurojë dokumentimin e plotë të të gjitha shërbimeve të realizuara gjatë periudhës së kontratës, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë së ndërhyrjeve dhe monitorimin e gjendjes teknike të pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri.

Pas çdo kontrolli, mirëmbajtjeje, testimi, kolaudimi, rimbushjeje ose trajnimi, operatori ekonomik duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin teknik përkatës, i cili duhet të përfshijë:

1. raportet e kontrollit dhe mirëmbajtjes;

2. certifikatat e testimeve dhe kolaudimeve;
3. evidencat e rimbushjeve dhe ndërhyrjeve teknike;
4. dokumentacionin e trajnimeve të realizuara.
5. Raportet teknike duhet të përmbajnë minimalisht:
6. identifikimin dhe vendndodhjen e pajisjes;
7. datën e realizimit të shërbimit;
8. gjendjen teknike të konstatuar;
9. kontrollat dhe testimet e kryera;
10. problematikat e evidentuara dhe masat korrigjuese ose rekomandimet teknike.

Dokumentacioni duhet të organizohet sipas objekteve dhe pajisjeve përkatëse dhe të jetë i disponueshëm për verifikim nga Autoriteti Kontraktor gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Afati i Ndërhyrjes Teknike

Operatori ekonomik duhet të garantojë reagim dhe ndërhyrje në kohë për çdo problematikë teknike të evidentuar gjatë kontroleve, mirëmbajtjeve, testimeve ose të raportuar nga Autoriteti Kontraktor, me qëllim rikthimin e pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri në gjendje funksionale.

Për defektet kritike që ndikojnë në sigurinë nga zjarri, ndërhyrja teknike duhet të realizohet brenda një afati maksimal prej 24 orësh nga momenti i njoftimit.

Raporti i ndërhyrjes duhet të përmbajë:

1. përshkrimin e defektit;
2. pajisjen ose sistemin e prekur;
3. masën korrigjuese të realizuar;
4. rezultatin pas ndërhyrjes.

Çdo ndërhyrje duhet të dokumentohet dhe të përfshihet në historikun teknik të pajisjes përkatëse.

Etiketimi dhe Gjurmueshmëria

Operatori ekonomik duhet të sigurojë që çdo pajisje kundër zjarrit e kontrolluar, mirëmbajtur, testuar, kolauduar ose rimbushur gjatë periudhës së kontratës të pajiset me etiketë teknike identifikuese, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë së shërbimeve të kryera dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së pajisjeve.

Etiketa duhet të jetë e qartë, e qëndrueshme dhe e lexueshme, dhe duhet të përmbajë minimalisht:

1. kodin ose numrin identifikues të pajisjes;
2. datën e kontrollit ose ndërhyrjes teknike;
3. datën e kontrollit të ardhshëm;
4. të dhënat e operatorit ekonomik që ka realizuar shërbimin;
5. emrin ose identifikimin e teknikut përgjegjës që ka kryer ndërhyrjen.

Sistemi i etiketimit duhet të jetë i lidhur me dokumentacionin teknik të operatorit ekonomik, në mënyrë që për çdo pajisje të mund të verifikohet historiku i kontrolleve, mirëmbajtjeve, testimeve, rimbushjeve dhe ndërhyrjeve të kryera gjatë periudhës së kontratës.

Etiketat e dëmtuara, të palexueshme ose të mungura duhet të zëvendësohen menjëherë, duke garantuar vazhdimësinë e identifikimit dhe gjurmueshmërisë së pajisjeve.

Grafiku i shërbimit

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimet e kontrollit, mirëmbajtjes, testimit dhe monitorimit të pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri sipas një grafiku periodik të miratuar, duke garantuar funksionimin e sigurt dhe të vazhdueshëm të tyre gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Shërbimet do të realizohen sipas intervaleve të mëposhtme:

Shërbime mujore:

1. kontroll vizual i pajisjeve dhe gjendjes së tyre fizike;
2. kontroll i presionit dhe treguesve teknikë;
3. verifikim i etiketave, vulave të sigurisë dhe afateve të kontrollit;
4. kontroll i sistemeve të alarmit dhe sinjalizimit të zjarrit.

Shërbime tremujore:

1. mirëmbajtje funksionale e pajisjeve;
2. kontroll i sistemeve hidrante dhe komponentëve përbërës;
3. realizim i testimeve funksionale të pajisjeve dhe sistemeve.

Shërbime gjashtëmujore:

1. rimbushje e pajisjeve kundër zjarrit sipas nevojës dhe rezultateve të kontrolleve;
2. kontrolle teknike të avancuara të pajisjeve dhe komponentëve;
3. verifikim i pajisjeve rezervë dhe sistemeve të furnizimit emergjent.

Shërbime vjetore:

1. kolaudim teknik i pajisjeve dhe sistemeve;
2. testim dhe certifikim i pajisjeve funksionale;
3. përgatitje e raportit teknik vjetor mbi kontrollet, ndërhyrjet dhe rekomandimet teknike.

Çdo shërbim i realizuar duhet të dokumentohet me raport teknik dhe t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktor për verifikim dhe monitorim.

Grafiku i shërbimit është hartuar me qëllim garantimin e kontrollit periodik, mirëmbajtjes së vazhdueshme, kolaudimit teknik dhe monitorimit të pajisjeve kundër zjarrit gjatë gjithë

periudhës kontraktore. Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimet sipas frekuencës dhe afateve të përcaktuara më poshtë, duke respektuar standardet teknike dhe kërkesat ligjore në fuqi.

Nr.	Shërbimi	Përshkrimi i aktivitetit	Frekuenca (muaj)	Frekuenca (3 muaj)	Frekuenca (6 muaj)	Frekuenca (vjetore)
1	Kontroll vizual i pajisjeve	Kontroll i gjendjes fizike, aksesit, sinjalistikës dhe vendosjes së pajisjeve	✓			
2	Kontroll i presionit të fikëseve	Verifikim i manometrave dhe parametrave të presionit	✓			
3	Kontroll i vulave dhe etiketave	Verifikim i vulave të sigurisë dhe afateve të kontrollit	✓			
4	Kontroll i tubave dhe aksesoreve	Evidentim i dëmtimeve, plasaritjeve ose bllokimeve	✓			
5	Kontroll i sistemeve të alarmit	Testim i sinjalizimit, sirenave dhe paneleve	✓			
6	Kontroll i ndriçimit emergjent	Verifikim i funksionimit të ndriçimit rezervë	✓			
7	Raport teknik mujor	Dorëzim raporti për gjendjen e pajisjeve dhe problematikat	✓			
	Mirëmbajtje funksionale e fikëseve	Kontroll i plotë teknik dhe funksional		✓		
	Kontroll i hidranteve	Verifikim i presionit, tubacioneve dhe valvulave		✓		
	Testim funksional i sistemeve të alarmit	Aktivizim testues i sistemeve		✓		
	Kontroll i daljeve emergjente	Verifikim i aksesueshmërisë dhe sinjalistikës		✓		

	Rimbushje e fikëseve sipas nevojës	Rimbushje e pajisjeve me pluhur, CO ₂ ose shkumë			✓	
	Kontroll teknik i avancuar	Verifikim i komponentëve të brendshëm			✓	
	Kontroll i baterive rezervë	Testim i kapacitetit funksional			✓	
	Kolaudim i plotë teknik	Kontroll i përgjithshëm dhe certifikim				✓
	Test hidrostatik	Testim i rezistencës së bombolave				✓
	Certifikim i pajisjeve	Lëshim certifikatash kolaudimi				✓
	Audit teknik i sistemeve kundër zjarrit	Vlerësim i gjendjes së përgjithshme				✓
	Raport përfundimtar vjetor	Raport i detajuar teknik dhe rekomandime				✓

Afati i kryerjes së shërbimit 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës .